



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Ministria e Financave

# Raporti fiskal mujor

*Janar-Gusht, 2010*

**Shtator, 2010**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>TREGUESIT FISKALE KRYESORË PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2010 .....</b>	<b>2</b>
<b>Analiza e të ardhurave për periudhën Janar-Gusht 2010 .....</b>	<b>2</b>
<b>Vështrim i përgjithshëm .....</b>	<b>2</b>
<b>Të ardhurat sipas taksave dhe burimeve të tjera .....</b>	<b>3</b>
Tatimi mbi vlerën e shtuar .....	3
Taksa doganore.....	4
Akciza.....	4
Tatimi mbi të ardhurat personale .....	5
Tatimi mbi fitimin .....	6
Taksat nacionale .....	7
Të ardhurat nga pushteti vendor .....	7
Të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore .....	7
<b>Analiza e shpenzimeve për periudhën janar-gusht 2010 .....</b>	<b>10</b>
<b>Vështrim i përgjithshëm .....</b>	<b>10</b>
<b>Shpenzimet korrente .....</b>	<b>11</b>
Shpenzimet e personelit .....	12
Shpenzimet për interesa .....	13
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes .....	14
Shpenzimet për subvencione .....	14
Shpenzimet për fonde speciale .....	15
Shpenzimet të pushtetit lokal .....	15
Pagesa e papunësisë .....	16
Ndihma ekonomike.....	16
Fondi rezervë i buxhetit të shtetit .....	17
<b>Shpenzimet kapitale .....</b>	<b>19</b>

**TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIUdhËN JANAR-GUSHT 2010**

Gjatë tetëmujorit 2010 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 206.1 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 5.8 përqind më të larta se e njëjta periudhe e një viti më parë. Në këtë periudhë, shpenzimet totale arritën në 229.3 miliardë leke (shih tabelen 1). Në linjë me politikën fiskale stabilizuese të Qeverisë, dhe në vijim të rishikimit në ulje të shpenzimeve për 2010 kundrejt buxhetit (rishikim që u finalizua me miratimin e buxhetit të ri në Korrik 2010), shpenzimet për tetëmujorin janë 5.5 përqind më të ulëta se në periudhën tetëmujore të 2009, dhe 7 miliardë më të ulëta se planifikimi në buxhetin fillestar. Ulja e shpenzimeve gjatë 2010 kundrejt një viti më parë reflektohet më shumë në shpenzimet kapitale, që janë reduktuar me rreth 40 përqind në bazë vjetore, ndërsa ato korente janë rritur me 8.4 përqind në bazë vjetore.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në 23.2 miliardë për këtë periudhë të 2010, me rënie të ndjeshme kundrejt të njëjtës periudhë të 2009 (47.8 miliardë lekë ishte deficiti fiskal i tetëmujorit të një viti më parë). Për këtë periudhë, deficiti ishte planifikuar në 7.5 miliardë lekë. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 230 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 18.4 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brëndshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 4.5 miliardë lekë.

Tabela 1. Treguesit kryesore të buxhetit të konsoliduar për periudhën Janar-Gusht


Miliardë lekë	Janar-Gusht '09	Janar-Gusht '10
TE ARDHURAT TOTALE	194.7	206.1
SHPENZIMET TOTALE	242.5	229.3
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	177.3	192.2
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	65.1	40.2
BILANCA FISKALE	-47.8	-23.2
BILANCI PRIMARE	-24.0	+3.4

**ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - GUSHT 2010****Vështrim i përgjithshëm**

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën tetëmujore arritën në 206.1 miliardë lekë, duke realizuar planin në masën 99.5 përqind dhe duke tejkaluar të ardhurat e një viti më parë me rreth 5.8 përqind. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 100.2 përqind ndaj parashikimit, ose rreth 144.3 miliardë lekë nga 143.9 miliardë lekë të planifikuara, me rritje vjetore 5.7 përqind; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 8 miliardë lekë nga 8.6 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar dhe nga 8.6 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat në fondet speciale arritën 35.51 miliardë lekë nga rreth 35.46 miliardë lekë të planifikuara, dhe kundrejt 33.6 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 5.7 përqind; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 2 miliardë lekë nga rreth 1.7 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 16.3 miliardë lekë nga 14.2 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 15 përqind.

Të ardhurat në dogana kanë patur ecuri të kënaqshme gjatë tetëmujorit. Gjatë kësaj periudhe janë mbledhur në total 76.9 miliardë lekë, 9.9 miliardë, ose 15 përqind më shumë se një vit më parë. Bazuar në të dhënat për tetëmujorin, të ardhurat në dogana përbëjnë 53.3 përqind të të ardhurave gjithsej në tatime dhe dogana, dhe 37.3 përqind të të ardhurave buxhetore gjithsej.

Nga administrata tatimore janë mbledhur në total për periudhën Janar - Gusht 67.4 miliardë lekë nga rreth 67.1 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar për 2010. Të ardhurat në tatime kanë një rënie prej 3.1 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, ose 2.1 miliardë lekë. Në grafikun më poshtë janë paraqitur të ardhurat sipas kategorive, për periudhën Janar -Gusht në vite.



## Të ardhurat sipas taksave dhe burimeve të tjera

### Tatimi mbi vlerën e shtuar


Të ardhurat totale nga TVSH-ja për periudhën Janar - Gusht 2010 janë rreth 74.1 miliardë lekë nga 74.8 miliardë të planifikuara për periudhën, që do të thotë 750 milionë lekë më pak. Krahasuar me tetëmujorin e parë të vitit 2009, të ardhurat nga TVSH-ja janë rritur me 4.2 përqind, ose 3 miliardë lekë më shumë.

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 54.7 miliardë lekë nga 54.6 miliardë lekë të parashikuara, duke realizuar planin e periudhës. Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 73.8 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë 5.7 miliardë lekë më shumë ose 11.7 përqind. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara dhe çmimet në import) si dhe kursi i këmbimit të lekut me monedhat kryesore të tregtisë ndërkombëtare të Shqipërisë, Euro-s dhe Dollar-it. Sipas të dhënave të INSTAT për tregtinë e jashtme<sup>1</sup>, importet në vlerë janë rritur me 11.4 përqind kundrejt një viti më parë, të ndikuara edhe nga rritja e çmimeve në import për mallrat kryesore dhe nga efekti i kursit të këmbimit (mesatarisht leku është zhvlerësuar me 6 përqind kundrejt një viti më parë ndaj Euro-s dhe 9 përqind ndaj Dollar-it). Rritjen vjetore më të lartë në vlerë për shtatëmujorin e kanë patur importet e këryre artikujve: minerale, lëndë djegëse; ushqime, pije, duhan; prodhime druri dhe letre; tekstile dhe

<sup>1</sup> Të dhënat më të fundit të disponueshme nga INSTAT i përkasin periudhës Janar-Korrik 2010.

këpucë, materiale ndërtimi dhe metale, ndërsa në ulje vazhdojnë të jenë gjatë këtij viti importet e makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi, me 8 përqind më pak se gjatë 2009.

Nga administrata tatimore për periudhën Janar - Gusht janë mbledhur 19.4 miliardë lekë nga 20.2 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë 4.2 përqind më pak. Të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 27.3 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime janë ulur me 2.8 miliardë lekë, ose 12.5 përqind. Në grafikun më poshte paraqiten të ardhurat nga TVSH-ja për tetëmuajorin në vite.



### Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Gusht janë rreth 4.6 miliardë lekë, sipas parashikimeve; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 324 milionë lekë, ose 6.6 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore bazë për këtë periudhë është 2.5 përqind. Lidhur me tarifat preferenciale, gjatë këtij viti po zbatohen reduktimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit (CEFTA), me Turqinë dhe me vendet e Bashkimit European.

### Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar - Gusht arritën në rreth 25.4 miliardë lekë duke shënuar rritje të konsiderueshme prej 12.8 përqind në krahasim me të njëjtën periudhë të një vit më parë, ose 2.9 miliardë lekë më shumë.

Nga administrata doganore janë mbledhur rreth 16.4 miliardë lekë, që përbëjnë 65 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza dhe ecuria e tyre ka qënë vendimtare në realizimin e këtij zëri në buxhet. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si dhe të mallrave të tjerë (me peshë më të vogël) që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga akciza në doganë janë 3.2 miliardë lekë më shumë, ose rreth 24 përqind. Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata për periudhën ka qënë si vijon: sasia e karburanteve të zhdoganuar për periudhën Janar - Gusht 2010 është 323.2 mijë ton, me rritje 11.3 përqind dhe te ardhura 26.8 përqind më të larta; sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar - Gusht 2010 është 2.6 mijë ton, me një ulje prej rreth 3 përqind; sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar - Gusht 2010 është 25.8


milionë litra, me një rënie prej 3 përqind, ndërsa të ardhurat e mbledhura nga Dogana për pijet alkoolike kanë qënë 10.4 përqind më ulët se një vit më parë.

Nga administrata tatimore janë mbledhur akciza rreth 9 miliardë lekë, me rënie vjetore 3 përqind. Të ardhurat nga akciza të mbledhura nga tatimet përbëjnë rreth 35 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Sipas grup mallrave, të ardhurat nga karburantet e prodhuara në vënd kanë pësuar një ulje prej 56 përqind; të ardhurat e mbledhura nga cigaret, përmes pullave fiskale, janë rritur me 20 përqind, si pasojë e rritjes së nivelit të taksimit të cigareve në Shtator 2009; të ardhurat e mbledhura nga pijet aloolike me pullë akcize kanë shënuar 15.9 përqind, pasi edhe për disa kategori të pijeve alkoolike akciza u rrit në Shtator 2009 me rreth 50 përqind

Tabela 2. Të ardhurat nga akciza sipas mallrave

Të ardhura, miliardë lekë	8 mujor 2009	8 mujor 2010	Ndryshimi %
Akciza mbi cigaret	6.3	7.6	20.2
Akciza karburante	14.0	15.6	11.5
Akciza pije alkoolike	1.3	1.3	-4.3
Të tjera	0.9	0.9	6.4

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të ardhurat nga akciza për tetëmuja në vite.



### Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 17.5 miliardë lekë, duke qënë 3.6 përqind më të ulëta se e njëjta periudhë e një viti më parë. Nga evidencat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që i referohen gjashtëmuja të parë të vitit 2010 rezulton se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 1.8 përqind, ose rreth 6700 njësi, kundrejt mesatares vjetore të 2009. Për sektorin privat rritja e numrit të të punësuarve (mesatare 6-mujor 2010 kundrejt mesatares 12 - mujor 2009) është prej 3.3 përqind ose rreth 7300 njësi. Megjithatë, brenda kësaj shifre, *subjektet me TVSH kanë një rritje të kontribuesve prej 4.7 përqind* ndërsa subjektet e biznesit të vogël një ulje prej 0.1 përqind. Numri mesatar i të punësuarve në sektorin publik (buxhetorë dhe ndërmarrje shtetërore) rezulton i reduktuar me 665 njësi, ose 0.4 përqind kundrejt mesatares së fundvitit 2009.


Sipas sektorëve të ekonomisë, rritje të theksuar ka në sektorin e prodhimit, (+5.5 përqind), ndërsa sektorët e tjerë nuk kanë luhajtje të mëdha: ndërtim (-0.2 përqind), transport (+2 përqind), tregtia (-0.4 përqind) dhe shërbimet (+1.5 përqind).

Sipas burimit të të ardhurave, të ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qenë rreth 5.5 miliardë lekë, me një rritje prej 4 përqind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jo-publik kanë qenë 5.3 miliardë lekë me rritje prej 13 përqind; të ardhurat nga interesat për periudhën janë në nivelin 1.8 miliardë lekë, pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Tabela 3. Të ardhurat nga taksimi individual sipas burimit të të ardhurave

Të ardhura, miliardë lekë	8 mujor 2009	8 mujor 2010	Ndryshimi %
Paga sektori publik	5.3	5.5	4.7
Paga sektori jo publik	4.7	5.3	13.4
Interesa	1.9	1.8	-1.2
Dividendë	0.7	1.1	58.2
Shitje pasuri e paluajtshme	15	1.5	5.5
Të tjera	4.2	2.2	-47.8

Në uljen e nivelit të të ardhurave të mbledhura nga tatimi mbi te ardhurat personale krahasuar me vitin 2009 ka ndikuar dhe zëri i të ardhurave të mbledhura mbi çmimin e shitjes në privatizimet e kompanive shtetërore (në masën 10 përqind). Gjatë vitit 2009 të ardhurat nga privatizimi për periudhën tetëmujore ishin 1.8 miliardë lekë, kundrejt zero lekë të këtij viti.



### Tatimi mbi fitimin


Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për tetëmujorin 2010 arritën në rreth 11.7 miliardë lekë nga 11.5 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të lehtë prej 1.5 përqind. Muaji Gusht ka patur ecurinë më të mirë në mbledhjen e këtij tatimi gjatë 2010, me një rritje të të ardhurave prej 68 përqind kundrejt muajit gusht të një viti më parë. Tatimi mbi fitimin e kompanive parapaguhet në bazë të fitimeve të realizuara gjatë periudhave të mëparshme të aktivitetit të tyre. Gjatë vitit 2009, fitimet e kompanive pësuan rënie dhe situata financiare e tyre u veshtrësua. Kjo ka ndikuar në uljen e kësteve të parapagimit të tatim fitimit për vitin 2010, siç pasqyrohet dhe nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mbi pagimin e kësteve të planifikuara për vitin në vijim. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga tatim fitimi dhe tatimi mbi të ardhurat personale për tetëmujorin në vite.

### Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën, janë 11.1 miliardë lekë nga 10.9 miliardë lekë të parashikuara për periudhën Janar - Gusht. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 2.7 miliardë lekësh, ose 32.3 përqind. Në grupin e taksave nacionale, zërat më të rëndësishem janë taksa e qarkullimit rrugor, renta minerare dhe taksa mbi importin e automjeteve të përdorura (e cila u ndryshua së fundmi, me efekte nga muaji Korrik 2010). Për tetëmujorin, 2.9 miliardë lekë janë mbledhur nga taksa e qarkullimit rrugor, ose 1.4 përqind më shumë se një vit më parë; të ardhurat nga renta kanë një rritje vjetore prej 76 përqind (gjithsej 2 miliardë lekë për 2010, kundrejt 1.1 miliardë të një viti më parë); të ardhurat nga taksa mbi importin e makinave të përdorura për periudhën tetëmujore janë 1.7 miliardë lekë, ose 10 përqind më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë.

### Të ardhurat nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar - Gusht arritën në 8 miliardë lekë nga 8.6 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar për 2010, ndërsa kundrejt tetëmujorit të parë të vitit 2009 të ardhurat janë ulur me 632 milionë lekë (rreth 7.3 përqind). Nga taksa vendore mbi biznesin e vogël janë mbledhur rreth 1.8 miliardë lekë, nga 2 miliardë lekë të planifikuara, duke qëndruar në të njëjtin nivel me të ardhurat e mbledhura gjatë tetëmujorit të parë të vitit 2009. Nga taksat mbi pasurinë, ku hyjnë taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore, të cilat përbëjnë 18 përqind të të ardhurave nga pushteti vendor gjithsej, janë mbledhur këtë periudhë 1.4 miliardë lekë nga 1.4 miliardë të parashikuara dhe 325 milionë, ose 30 përqind më shumë se një vit më parë. Taksat e tjera vendore kanë mbledhur rreth 4.8 miliardë lekë nga 5.3 të parashikuara, dhe 16 përqind më pak se vitin e kaluar. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga taksat vendore për tetëmujorin e parë në vite.



### Të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën Janar - Gusht 2010 arritën në 35.5 miliardë lekë, me një rritje prej 5.7 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 34.3 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.



Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 30.1 miliardë lekë, gati në të njëjtin nivel të vitit 2009; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 4.2 miliardë lekë, 22.7 përqind më shumë se tetëmuji i një viti më parë. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga fondet speciale për pesëmujorin e parë në vite.





Tabela 4. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik

	EMERTIMI	8 Mujor 2009 mld leke	8 Mujor 2010 mld leke	Ndryshimi %	Kundrejt planit %
	<b>TË ARDHURAT NE BUXHETIN E KONSOLIDUAR</b>	<b>194.7</b>	<b>206.1</b>	<b>5.6</b>	<b>-0.5</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>178.8</b>	<b>187.8</b>	<b>5.0</b>	<b>-0.2</b>
<b>I</b>	<b>Tatimet mbi te ardhurat</b>	<b>31.4</b>	<b>30.9</b>	<b>-1.6</b>	<b>1.6</b>
<i>I.1</i>	<i>Tatimi mbi të ardhurat personale, nga I cili:</i>	<i>18.1</i>	<i>17.5</i>	<i>-3.7</i>	<i>0.9</i>
	Tatimi mbi pagën në sektorin publik	5.3	5.3	4.7	
	Tatimi mbi pagën në sektorin jopublik	4.7	5.3	13.4	
	Tatimi mbi të ardhurat nga interesat	1.9	1.8	-1.2	
	Tatimi mbi të ardhurat nga dividendet	0.7	1.1	58.2	
	Tatimi mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë	1.4	1.5	5.5	
	Të tjera	4.2	2.2	-47.8	
<i>I.2</i>	<i>Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi</i>	<i>13.3</i>	<i>13.4</i>	<i>0.9</i>	
	Tatim fitimi	11.5	11.7	1.5	4.6
	Taksa mbi biznesin e vogël	1.8	1.8	-2.3	-10.5
<b>II</b>	<b>Të ardhurat në fondet speciale</b>	<b>33.6</b>	<b>35.5</b>	<b>5.7</b>	<b>0.2</b>
<b>III</b>	<b>Taksimi i pasurisë</b>	<b>1.3</b>	<b>1.4</b>	<b>11.9</b>	
	Tatimi mbi ndërtesat	0.9	1.0	19.2	
	Tatimi mbi tokën bujqësore	0.2	0.3	12.0	
	Taksa mbi kalimin e pasurisë	0.2	0.1	-26.5	
<b>IV</b>	<b>Taksat indirekte mbi mallrat dhe shërbimet</b>	<b>93.6</b>	<b>99.5</b>	<b>6.3</b>	
<b>IV.1</b>	<b>Tatimet mbi shitjen</b>	<b>71.1</b>	<b>74.1</b>	<b>4.2</b>	<b>-1.0</b>
	TVSH mbi shitjet brënda vëndit	22.2	19.4	-12.5	-4.2
	TVSH mbi mallrat e importuara	49.0	54.7	11.7	0.2
<b>IV.2</b>	<b>Akcizat</b>	<b>22.5</b>	<b>25.4</b>	<b>12.8</b>	<b>0.6</b>
	Mbi karburantet	14.0	15.6	11.5	
	Mbi alkoolin dhe nënproduktet e tij	1.3	1.3	-4.3	
	Mbi duhanin dhe nënproduktet e tij	6.3	7.6	20.2	
	Të tjera (kafe, etj)	0.9	0.9	6.4	
<b>V</b>	<b>Taksimi i automjeteve</b>	<b>3.3</b>	<b>3.4</b>	<b>17.1</b>	
	Taksa për regjistrimin e automjeteve	0.5	0.5	6.5	
	Taksa e qarkullimit rrugor	2.4	2.9	19.2	
<b>VI</b>	<b>Të tjera taksa mbi mallra dhe shërbime (nacionale)</b>	<b>6.0</b>	<b>8.2</b>	<b>37.6</b>	
<b>VII</b>	<b>Taksat mbi tregtinë ndërkombëtare</b>	<b>4.9</b>	<b>4.6</b>	<b>-6.1</b>	<b>-1.0</b>
<b>VIII</b>	<b>Të tjera taksa lokale</b>	<b>5.1</b>	<b>4.3</b>	<b>-15.3</b>	
<b>B</b>	<b>Të ardhura jo tatimore</b>	<b>14.2</b>	<b>16.3</b>	<b>14.6</b>	<b>-2.5</b>
<b>C</b>	<b>Grante</b>	<b>1.7</b>	<b>2.0</b>	<b>16.6</b>	<b>-14.8</b>

## ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR - GUSHT 2010

### Vështrim i përgjithshëm

**Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit**, në fund të tetëmujorit 2010, arritën në rreth 229.3 miliardë leke, nga rreth 233.5 miliardë leke të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 98.2 përqind të parashikimit të periudhës, ose me një mosrealizim prej rreth 4.2 miliardë leke. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 61.7 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 13.3 miliardë leke më pak, ose rreth 5.5 përqind më të ulëta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute, ritmi i rritjes së tyre gjatë tetëmujoreve, në disa vite, jepet në grafikun e mëposhtëm:



Në analizën e shpenzimeve **duhet mbajtur parasysh edhe fakti** se deri në fund të tetëmujorit 2010, shpenzimet e kryera nëpërmjet përdorimit të fondit rezerve të Këshillit të Ministrave dhe kontigjencës, janë reflektuar në zërat e shpenzimeve ku ato janë kryer, si më poshtë:

- Fondi rezerve i Këshillit të Ministrave prej rreth 1842.8 milionë leke, i ekzekutuar deri në fund të tetëmujorit 2010, është përdorur në rreth 22.8 milionë leke për shpenzime për paga, në rreth 3 milionë leke në shpenzime për sigurime shoqërore, në rreth 500 milionë leke për subvencione, në rreth 301.5 milionë leke për shpenzime të tjera korrente dhe në rreth 515.6 milionë leke për investime.
- Fondi i kontigjencës prej 2.7 miliardë leke, i ekzekutuar deri në fund të tetëmujorit 2010 është përdorur në rreth 1.5 miliardë leke për shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes dhe rreth 1.2 miliardë leke për subvencion.


Shpenzimet e përgjithshme sipas elementeve kryesore përbërës të tyre, realizuar gjatë periudhës Janar - Gusht 2000 - 2010, në milionë leke, jepen në tabelën e mëposhtme:

## SHPENZIMET NE VITE


ne milion leke

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>101,144</b>	<b>113,567</b>	<b>113,434</b>	<b>122,568</b>	<b>131,382</b>	<b>140,683</b>	<b>132,554</b>	<b>145,859</b>	<b>193,951</b>	<b>242,518</b>	<b>229,267</b>
<b>I. Shpenzime Korrente</b>	<b>83,761</b>	<b>88,865</b>	<b>95,404</b>	<b>105,672</b>	<b>114,312</b>	<b>121,717</b>	<b>121,124</b>	<b>128,609</b>	<b>149,853</b>	<b>177,330</b>	<b>192,242</b>
1 Personeli	20,520	25,363	25,248	27,452	30,319	33,571	34,725	34,922	40,990	40,234	42,563
2 Interesat	22,735	16,841	16,409	20,389	20,288	17,971	17,508	16,900	21,065	23,804	26,552
3 Shpenzime Operative Mirembajtje	10,169	9,401	11,813	13,243	14,131	14,530	11,917	12,746	14,611	18,726	20,567
4 Subveconet	1,696	4,856	4,940	2,298	2,785	2,159	1,470	1,539	1,388	1,422	3,020
5 Shpenzime per Sig.Sociale	19,889	22,958	25,688	28,647	32,179	35,868	38,417	44,432	48,759	62,378	68,437
6 Buxheti lokal	3,265	3,821	5,850	8,178	8,746	11,017	10,746	10,840	14,815	20,786	19,306
7 Shpenzime te tjera	5,487	5,625	5,456	5,465	5,864	6,601	6,341	7,230	8,225	9,980	11,797
<b>II. Shpenzime Kapitale</b>	<b>16,635</b>	<b>23,286</b>	<b>18,030</b>	<b>16,896</b>	<b>17,070</b>	<b>18,966</b>	<b>11,430</b>	<b>17,250</b>	<b>41,814</b>	<b>65,103</b>	<b>40,241</b>
1 Financimi Brendshem	9,218	12,705	8,962	9,909	10,915	12,692	7,952	12,552	16,637	55,424	30,258
2 Financimi Huaj	7,417	10,581	9,068	6,987	6,155	6,274	3,478	4,698	25,177	9,679	9,983

Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë tetëmuorit 2010, shpenzimet korrente zënë rreth 83.9 përqind, nga rreth 81.1 përqind të parashikuara, ndërkohë që shpenzimet për investime zënë 17.6 përqind nga 17.8 përqind të parashikuara. Një vit më parë struktura e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit të shtetit të realizuara gjatë periudhës Janar - Gusht, ishte rreth 73.1 përqind shpenzimet korrente dhe rreth 26.9 përqind shpenzime kapitale.

**Shpenzimet Korrente**

**Shpenzimet korrente** në fund të muajit Gusht 2010, kanë arritur në rreth 192.2 miliardë lekë dhe krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 63.7 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 14.9 miliardë lekë më të larta, ose rreth 8.4 përqind më shumë.




Sipas zërave përbërës të shpenzimeve korrente, situata e realizimit të tyre në fund të muajit Gusht 2010, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:


	Shpenzimet korrente	Parashikimi Janar -Gusht 2010 në mln lekë	Realizimi Janar - Gusht 2010		
			Në milionë lekë	Në %	Struktura në %
1	Shpenzime personeli	42.96	42.56	99.08	22.1
2	Interesa	26.78	26.55	99.15	13.8
3	Shpenz oper. mirëmbajtjes	19.61	20.57	104.88	10.7
4	Subvensionet	1.24	3.02	244.17	1.6
5	Shpenzimet për fonde speciale	67.92	68.44	100.76	35.6
6	Shpenzimet buxh. vendore	19.02	19.31	101.50	10.0
7	Shpenzime të tjera	11.75	11.80	100.41	6.2
8	Kompensimi i pronarëve				
	<b>Totali i shpenzimeve korrente</b>	<b>189.28</b>	<b>192.24</b>	<b>101.57</b>	<b>100.0</b>

### Shpenzimet e Personelit

Brënda shpenzimeve korrente, **shpenzimet e personelit**, që përfaqësojnë rreth 22.1 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës Janar - Gusht 2010, rezultojnë me një mosrealizim prej rreth 396 milionë lekë, ose rreth 99.1 përqind të parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime në fund të muajit Gusht janë realizuar në rreth 63.7 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 2.3 miliardë lekë më të larta, ose rreth 5.8 përqind më shumë.




Shpenzimet për paga janë rreth 146 milionë lekë më pak se parashikimi i periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 2.9 miliardë lekë më të larta se e një viti më parë, ose rreth 8.4 përqind më shumë se e një viti më parë, ndërkohe që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 527 milionë lekë më pak, ose rreth 8.4 përqind më të ulëta, se e një viti më parë.




### Shpenzimet për Interesa

**Shpenzimet për interesa** që përfaqësojnë rreth 13.8 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës Janar - Gusht 2010, rezultojnë me një kursim prej rreth 228 milionë lekë, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 99 milionë lekë në interesat e brëndshme dhe rreth 128 milionë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 61.0 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 2.7 miliardë lekë më të larta, ose rreth 11.6 përqind më shumë. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë tetëmuajve të viteve, në vite jepet nga grafiku i mëposhtem:




### Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

**Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes** gjatë periudhës Janar - Gusht 2010 arritën në rreth 20.6 miliardë lekë, duke qënë rreth 957 milionë lekë mbi nivelet e parashikuara. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 66.7 përqind të tij. Në të njëjtën kohë ato rezultojnë rreth 1.8 miliardë lekë, ose rreth 9.8 përqind më shumë se nivelet e realizimit të vitit të kaluar.



### Shpenzimet për Subvensione


**Shpenzimet për subvensione** në fund të muajit Gusht 2010 arritën në rreth 3.0 miliardë, rrjedhojë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve të ujësjellësve për energjinë elektrike.



### Shpenzimet për Fonde Speciale

**Shpenzimet për fonde speciale** gjatë periudhës Janar - Gusht 2010 rezultojnë rreth 516 milionë lekë më shumë, apo rreth 0.8 përqind mbi nivelin e parashikimit të periudhës. Kjo situatë është kryesisht rrjedhojë e tejkalimit të shpenzimeve prej rreth 741 milionë lekë për kompensimin e ish pronarëve. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 62.8 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 64.6 përqind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore janë realizuar në rreth 62.8 përqind të këtij plani dhe kompensimi i pronareve në rreth 61.2 përqind.

Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 3.4 miliardë lekë më të larta, ose rreth 7.2 përqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 1.6 miliardë lekë më të larta, ose rreth 10.9 përqind më shumë.




### Shpenzime të Pushtetit Lokal

**Shpenzimet e pushtetit lokal** zënë 10.0 përqind të shpenzimeve korrente. Për periudhën Janar - Gusht 2010 ato kanë arritur në rreth 19.3 miliardë lekë, ose rreth 285 milionë lekë më shumë se



niveli i planifikuar për këtë periudhë të vitit 2010. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kane arritur në rreth 63.5 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 1.5 miliardë lekë më të ulëta, ose rreth 7.1 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit lokal për periudhën Janar - Gusht për disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.




### Pagesa e Papunësisë

**Pagesa e papunësisë** rezulton në rreth 217 milionë lekë mbi parashikimin e periudhës, ose rreth 92.2 përqind e planifikimit vjetor, duke qënë rreth 62.5 përqind më shumë se një vit më parë.

### Ndihma Ekonomike

**Ndihma ekonomike** gjatë periudhës Janar - Gusht 2010 rezulton rreth 370 milionë lekë më pak, ose rreth 3.4 përqind nën parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 61.1 përqind e planit vjetor.



Deri në fund të muajit Gusht 2010 një fond prej rreth 500 milionë lekë është dhënë për **kompensimin në vlerë të ish të përndjekurve politike**, fond i cili përfaqëson rreth 35.7 përqind të planifikimit vjetor.

**Fondi rezervë i buxhetit të shtetit**

Deri në fund të muajit Gusht 2010, **fondi rezerve i buxhetit të shtetit**, është prekur nëpërmjet 58 vendimeve të Këshillit të Ministrave, në shumën prej rreth 1.9 miliardë lekë, nga 2.5 miliardë lekë të planifikuar për t'u përdorur, ose rreth 75.8 përqind e tij.

*Ne milione leke*

	<b>Parashikuar për vitin 2010</b>	<b>Përdorur me vendime të KM</b>	<b>Ekzekutuar</b>	<b>Përqindja (Përdorur/parashikuar)</b>
<b>Fondi Rezervë</b>	<b>2500.0</b>	<b>1895.3</b>	<b>1842.8</b>	<b>75.8</b>


Nga 58 vendime të Këshillit të Ministrave të miratuar për përdorimin e fondit rezervë deri në fund të muajit Gusht 2010, vetëm dy vendime, e konkretisht:

- Vendimi nr.527 datë 17.6.2010 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Kryeministrinë", me vlerë totale prej 27.5 milionë lekë, dhe
- Vendimi nr. 668 datë 4.8.2010 "Për një shtese fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2010, për MTKRS, për realizimin e veprimtarive kushtuar 100 vjetorit të lindjes së Nënë Terezës", me vlerë totale prej rreth 24.9 milionë lekë, nuk ishin ekzekutuar deri në fund të muajit Gusht.

Nga fondi i ekzekutuar, prej rreth 1.84 miliardë lekë, rreth 1.4 përqind është përdorur për shpenzime personeli, rreth 27.1 përqind për subvencion, rreth 43.5 përqind për shpenzime të tjera korrente dhe rreth 28.0 përqind për investime, siç paraqitet edhe nga tabela dhe grafiku i mëposhtëm.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, sipas zërave të shpenzimeve;

		<b>Fondi rezervë i ekzekutuar</b>	
		<b>Në milionë lekë</b>	<b>Në përqindje</b>
1.	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>25.8</b>	<b>1.4</b>
	-Shpenzime për paga	22.8	1.2
	-Shpenzime për sig.	3.0	0.2
2.	<b>Shpenzime të tjera korrente</b>	<b>801.5</b>	<b>70.6</b>
	-Shpenz operativ+mirëmbajtjen	339.6	18.4
	-Subvensionet	500.0	27.1
	-Transfertat e brëndshme	380.7	20.7
	-Transfertat e jashtme	79.5	4.3
	-Transfertat tek familjarët/individ.	1.6	0.1
3.	<b>Investime</b>	<b>515.6</b>	<b>28.0</b>
	-Të patrupëzuara	9.7	0.5
	-Të trupëzuara	505.9	27.5
	<b>TOTALI</b>	<b>1842.8</b>	<b>100.0</b>



Rreth 516 milionë lekë, ose rreth 27.2 përqind e fondit rezerve i janë dhënë Ministrisë së Transportit, për pagesën e detyrimeve për energji elektrike të shoqërive të ujësellsave.

Rreth 22.8 % e fondit rezervë, ose rreth 431.5 milionë lekë i janë dhënë Ministrisë së Brëndshme, nga të cilat përmendim fondet për emergjencat civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmytjet natyrore; Fondet për dëmet e shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e tërmetit, në Qarkun e Dibrës; fondet për komunën Paskuqan, për zbatimin e projektit emergjent "Rreshqitja e varrezave në Paskuqan, për marrjen e masave rehabilituese dhe mbrojtëse"; fondet për zbatimin e projektit "Rehabilitimi i mbulesave të pallateve në lagjen nr.1, Kukës"; fondet për Bashkinë Krujë, të qarkut të Durrësit, për zbatimin e projekteve emergjente, që lidhen me marrjen e masave rehabilituese dhe mbrojtëse nga fatkeqësi të ndryshme; për dhënie ndihme financiare familjës së Z.Gjetan Pjeter Lala, të cilës i është dëmtuar banesa nga fatkeqësitë natyrore; për dhënie ndihme financiare familjes së Z.Artur Kaja, të cilës iu shkaktuan dy viktima dhe tre të plagosur rëndë nga zjarri i rënë në banesë, më datë 22.11.2009; për realizimin e një spoti publicitar për informimin e shtetasve shqiptare në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave, etj.

Rreth 244 milionë lekë, ose rreth 12.9 përqind i është akorduar Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, për ndërhyrjet emergjente në objektet e mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuareve dhe për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Për Kryeministrinë është përdorur rreth 10.9 përqind e këtij fondi, ose rreth 206.6 milionë lekë.

Rreth 55.4 milionë lekë, ose 2.9 përqind e këtij fondi është përdorur për dhënie ndihme financiare qeverisë së Kosovës, për realizimin e projekteve të propozuara për komunën Gracanicë, Kosovë.

Rreth 53.4 milionë lekë, ose rreth 2.8 përqind e fondit rezervë është përdorur për një shtesë në buxhetin e vitit 2010, për Ministrinë e Drejtësisë, për mbulimin e shpenzimeve të qirasë së zyrave të misionit EURALIUS, etj.

Në sektorin e shëndetësisë, është akorduar rreth 49.0 milionë lekë, ose rreth 2.6 përqind e totalit të fondit rezerve të Këshillit të Ministrave. Ky fond ka shërbyer kryesisht për të përballuar shpenzimet, të cilat lidhen me kurimin e njerëzve, që kanë patur nevojë për kurim jashtë vëndit dhe për mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e implantimit koklear, për disa fëmijë.

Rreth 152.1 milionë lekë, ose rreth 8.0 përqind e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, i janë akorduar Ministrisë së Financave, për kryerjen e rikonstruksionit të Akademisë së Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për dhënie


ndihme financiare qeverisë së Republikës së Moldavisë dhe qeverisë së Republikës Islamike të Pakistanit, për lehtësimin e pasojave, të shkaktuara nga përmbytjet.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë më të plotë të përdorimit të këtij fondi, sipas institucioneve për periudhën Janar - Gusht 2010.

Përdorimi i Fondit Rezervë	Nr. vendimesh	Në milionë lekë	Në përqindje
Kryeministria	4	206.6	10.9
Ministria e Ekonomisë	1	19.0	1.0
Ministria e Bujqësisë	2	244.0	12.9
Ministria e Transportit	3	516.0	27.2
Ministria e Financave	6	152.1	8.0
Ministria e Shëndetësisë	11	49.0	2.6
Ministria e Drejtësisë	3	53.4	2.8
Ministria e Brëndshme	18	431.5	22.8
Instituti i Statistikave	1	39.2	2.1
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	1	55.4	2.9
KQZ-ja	1	3.9	0.2
Ministria e Integritit	2	29.6	1.6
MTKRS dhe MPCSSHB	2	53.1	2.8
Të tjera	3	42.5	2.2
<b>Totali</b>	<b>58</b>	<b>1895.3</b>	<b>100.0</b>

## Shpenzimet Kapitale

**Shpenzimet kapitale** deri në fund të muajit Gusht 2010 janë realizuar në rreth 60.9 përqind të planit vjetor. Brënda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brëndshëm janë realizuar në masën 72.3 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 47.2 përqind të parashikimit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brëndshme rezultojnë rreth 25.2 miliardë lekë më të ulëta, ose rreth 45.4 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 304 milionë lekë më të larta, ose rreth 3.1 përqind më shumë. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit Gusht 2010 janë rreth 38.2 përqind më të ulëta, ose rreth 24.9 miliardë lekë më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës Janar - Gusht 2010 është rreth 75.2 përqind nga financimi i brëndshëm dhe rreth 24.8 përqind nga financimi i huaj. Ecuria e investimeve kapitale me financim të brëndshëm dhe me financim të huaj gjatë tetëmuajorëve të parë në disa vite, paraqitet nga grafiku i mëposhtëm.

